



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.70 dt.05.06.1998

**PER  
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN PRILL 1998**

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi relacionin, projekt – vendimin dhe borderotë e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore,

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **9934 familje** me një fond prej **31.195.407 lekë**. Për çdo njësi administrative si vijon :

<b>Nj.A.</b>	<b>FAMILJE</b>	<b>FONDI</b>	<b>Nj.A.</b>	<b>FAMILJE</b>	<b>FONDI</b>
<b>1.</b>	873	2.724.103	<b>7.</b>	708	<b>2.234.249</b>
<b>2.</b>	862	2.559.938	<b>8.</b>	682	<b>2.099.620</b>
<b>3.</b>	828	2.590.209	<b>9.</b>	797	<b>2.498.695</b>
<b>4.</b>	1.247	3.981.551	<b>10.</b>	544	<b>1.592.796</b>
<b>5.</b>	1.121	3.556.052	<b>11.</b>	991	<b>3.325.588</b>

<b>6.</b>	<b>1.281</b>	<b>4.032.606</b>			
-----------	--------------	------------------	--	--	--

2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike **541 familje** sipas listave të paraqitura nga njësitet administrative, **25 familje** me automjet të Nj.Administrative Nr.1 të kthejnë lekët sipas listës së bashkëngjitur.
4. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **144 familje** sipas pasqyrës bashkëngjitur në relacion.
5. Të trajtohen me ndihmë ekonomike në nivelin maksimal për familjet me 1 antar, Pëllumb Mbrakulli, Qamile Celiku, Nj.A.1, Farlizet Demalli Nj.A.3.
6. Të trajtohen me ndihmë ekonomike si rast i veçantë për 1 vit si familje me 1 antar, Nermin Harxhi, Nj.A.1, Alma Beqiri, Nj.A.11, Skifter Ramçi familje me 7 antarë Nj.A.3 për një periudhë për 3 muaj.
7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për paaftësi **1632 persona** me aftësi të kufizuar dhe **65 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar gjithsej me një fond prej **5.631.190 lekë**.
8. Me propozim dhe miratim të Këshillit Bashkiak të trajtohet me ndihmë ekonomike Bilal Brahja familje me 5 antarë Nj.A.2.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**